



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA KORÇË
NDËRMARRJA E SHËRBIMEVE PUBLIKE**

Nr. _____ Prot.

Data .08.2023

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Sherbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Riparime e mirëmbajtje mjete transporti”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

- Riparime, mirëmbajtje dhe shërbime të lidhura me automjete dhe pajisje të lidhura **(5010000-6)**
- Shërbime riparimi dhe mirëmbajtje makinash **(50112000-3)**

VLERA E FONDIT LIMIT: 2,800,000 (dy milion e tetëqind mijë) lekë PA TVSH .

Autoriteti kontraktor ka llogaritur fondin limit duke marre 3 (tre) oferta nga operatorët ekonomike që operojnë në treg dhe duke përlogaritur vlerën mesatare të tyre në përputhje me parashikimet ligjore të nenit 76, paragrafi i parë pika b) ,të Vendimit nr. 285, datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik i ndryshuar”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,autoriteti/enti kontraktor **Ndermarrja e Sherbimeve Publike, Bashkia Korçë**ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës ...;*
- b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, i ndryshuar, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.1.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare: **2021, 2022, 2023**, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se **vlera e parashikuar e kontrates**.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43 paragrafi 2 pika b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Ky kriter i sherben autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës, prandaj është kërkuar që vlera e xhiros të jete jo më e vogël se vlera e fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin 43 pika 2b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në: nenin 43 pika 1 e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, nëzbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM-së Nr.922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formes elektronike”, si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.2 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.2.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se **35%** të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të e mallrave të furnizuara,

- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 35 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin 40, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

2.3 Kapaciteti ligjor/profesional i operatoreve ekonomik

Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me Licencën e kategorise VII.B.1

“Riparim dhe mirembajtja e pjesëve mekanike dhe të motorit, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove”, për pikat a, b, c, ç, në përputhje me legjislacionin, për lejat dhe licencat, si dhe Udhezimin e ministries së transportit dhe infrastruktures me nr.1546, datë 29.03.2016, “Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove”, për ambientin ku ushtron këto aktivitete.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe ligjit nr. 10081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 538, datë 26.5.2009, “Për licencat dhe lejet, që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, të ndryshuar; Udhezimin e ministries së transportit dhe infrastruktures, me nr.1546, datë 29.03.2016, “Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove”.

2.3.1 Deshmi per fuqine mesatare puntore te operatorit ekonomik

Per te garantuar cilesine e punes gjate sherbimit dhe montimin, Operatoret ekonomik ofertues duhet te vertetojne se ka te punesuar ne listpagesen **4 (kater) punonjes** te kualifikuar minimumi per muajin e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave si më poshtë:

- (nje) inxhinier mekanik ose teknik/mekanik transporti per te cilin duhet te paraqitet:
 - Diplome
 - Kontrate pune

- 1(nje) motorist
- 1(nje) xhenerik,
- (nje) elektroaut,

Per te cilet duhet te paraqitet

- Deshmi kualifikimi
- Kontrate pune

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”.

- Operatori ekonomik ofertues duhet te disponoje te pakten 1 (nje) objekt me siperfaqe jo me pak se 30 m², me grope ku mund te qendroje nje autoveture ose sipas rastit nje kamion, per kryerjen e sherbiomit te riparimit dhe mirembajtjes se automjeteve. (Ne pronesi ose me qera)

Per te vertetuar sa me siper ofertuesi duhet te paraqese:

-Ne rast se objekti eshte ne pronesi duhet te paraqitet : certifikata e pronesise.

-Ne rast se objekt eshte me qera duhet te paraqitet : kontrata e qerases e vlefshem per te gjithë peridhen e realizimit objekt i prokurimit e shoqeruar me certifikaten e pronesise.

Per sa me siper per secilin nga rastet ofertuesi duhet te deklaroje se:

1.Ka nje servis të specializuar për kryerjen e shërbimeve dhe riparimeve të mjeteve motorike sipas kërkesave te autoritetit dhe adresen e sakte e servisit.

- Operatori ekonomik duhet te disponoje pajisje dhe instrumente minimale te nevojshme per zbatimin e kontrates,si me poshte:
 - Pajisje bango prove per motorrin dhe altenator (dinamo)
 - Pajisje bango prove per injatore dhe pompe nafte

Per te vertatuar disponimin e pajisjeve me siper operatori ekonomik duhet te paraqese dokumentat qe vertetojne se keto pajisje dhe instrumente i ka ne pronesi, ose me qera.

Per sa me siper ne rast se pajisjet jane ne pronesi operatori ekonomik duhet te paraqese faturen e blerjes dhe/ose fotografi.

Ne rast se jane me qera duhet te paraqitet kontrata e qerese dhe/ose fatura e blerjes dhe /ose fotografi.

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

Shënim: Vendodhja e servisit duhet të jete jo më larg se 30km nga vendndodhja e oficinës së mjeteve të Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike.

Për të gjitha ato mjete të cilat rezultojnë me defekte të mëdha dhe nuk mund të lëvizin, operatori ekonomik duhet të vijë t’i marrë me shpenzimet e veta deri ne servisin e deklaruar prej tij.

Argumentim: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar në bazë të nenit të 77, pika 1 c) të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, ku shprehimisht thuhet se: “Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha*

kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës...”, nenit 40, pika 5 ç) dhe nenit 41 pika 6 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Termet e references, sasitë, specifikimet teknike janë hartuar nga personat përgjegjës për hartimin e specifikimeve teknike caktuar me urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike Nr.244 Prot., date 24.06.2024.

Ato janë si me poshte:

Specifikimet:

Nr		Përshkrimi i mallit	Njesia	Sasi
		MAN VINC +BORPASTRUSE WMAF044009M202043AA 428 XJ		
1	F.V	Riparim i pompes hidraulike te timonit	set	1
2	F.V	Riparim i sistemit te ftohjes pompe+radiator	cope	1
3	F.V	Riparim pistonit hidraulik kazani +shperndaresi	set	1
4	F.V	Nderim sofjet ajri	cope	2
5	F.V	Riparim kazani + gabine	set	2
		Platforma levizese AA 504 YG Haulotte nr.serieAD112610		
1	F.V	Riparim i pistonit te koshit	set	2
		RULI VOLVO DD 15 VCE00D15K0S270093 viti 2013		
1	F.V	Riparim pompe hidraulike	set	1
2	F.V	Ndrimi tubave hidraulik	cope	1
		MINI ESKAVATOR KUBOTA JAPONEZ BK41B36015 viti 2004		
1	F.V	Riparim pompe hidrauliku + shperndares	set	1
2	F.V	Nderim bokullash te koves	set	1
3	F.V	Nderim Rrotat drejtuese	cope	2
		KAMION ASTRA 4 nr.ZCNH78445ZH450026 viti 2000 AA981 UC		
1	F.V	Ndrimi I pulexhove+ripa	set	1
2	F.V	Ndrim balestre	cope	2
3	F.V	Nderim firsamonika te filtrove te ajrit	cope	2

4	F.V	Nderim depozite vaji hidraulikut te timonit	cope	1
5	F.V	Nderim amortizator te gabines	cope	4
6	F.V	Nderim amortizator te aksit para	cope	2
7	F.V	Nderim fosjeta frenash te mbrapa+para	cope	2
8	F.V	Nderim ferrota para+ mbrapa	cope	4
		Ford Tranzit NYWF0DXXGBVDKP12460 AA 239 NY		
1	F.V	Riparim motori (kemish,fasho ,pistona,guarnicion testate)	set	1
2	F.V	Nderim pasqyra ferrota para	set	2
3	F.V	Nderim cepa mbrapa	set	2
4	F.V	Riparim grup I timonit	set	1
		Mitsubishi Pajero JMB0NV44MJ310837 Viti1991 AA 368 OR		
1	F.V	Riparim motorino + dinamo (pinion,automat,karbocina,kolektor)	set	1
2	F.V	Riparim i sistemit I drejtimi zbare,koke paraleli,amortizator para	set	1
3	F.V	Nderim transmisioni ,kryqe ,kuzhinjete	set	1
4	F.V	Nderim pasqyra ferrota para	set	1
		Targa AA 231 GR WF0FXXTTFFDB48192 FORD 2013 TTFF		
1	F.V	Riparim i pistonit hidraulik te ngritjes se kazanit+tubo hidraulike	set	1
2	F.V	Nderim cepa freni mbrapa+ferrota	set	2
3	F.V	Nderim Guzhinjeta para	cope	2
		Targa AA 226GR WF0FXXTTFFDB48179 Voskop Ford 2013 TTFF		
1	F.V	Riparim sistemi i transmisionit (kryqe,gushineta kryqi,gushinet nivelimi)	set	1
2	F.V	Nderim pompe freksioni	set	1
3	F.V	Nderim automat kazani hidraulik	cope	1
4	F.V	Nderim cepa freni mbrapa+ferrota	set	2
		Tag. AA228GR WF0FXXTTFFDB48185Bulgarec Ford 2013 TTFF		
1	F.V	Riparim sistemi I transmisionit (kryqe,gushineta kryqi,gushinet nivelimi)	set	1
2	F.V	Riparim i sistemit te ftohjes pompe+radiator	set	1
3	F.V	Nderim pompe freksioni	set	1
4	F.V	Nderim Guzhinjeta para	set	1
		Kamion,IVEKO 440T/P ,viti 2006 ,shasi WJME3TST20C169074 ,AB383IK		
1	F.V	Riparim sistemi I transmisionit (kryqe,gushineta kryqi,gushinet nivelimi)	set	1
2	F.V	Riparim i sistemit te ftohjes pompe+radiator	cope	1
3	F.V	Riparim pistoni hidraulik kazani +shperndaresi	set	1
4	F.V	Nderim ferrota para+ mbrapa	cope	4
5	F.V	Nderim kondicioneri	cope	1
		Ruli Bomag MT BW177 AF MT 10 nr. 101581071036 (2001)		
1	F	Riparim i sistemit te levizjes dhe ndryshimit te shpejtesise (ASC)	set	1
2	F.V	Riparim i sistemit hidraulik	set	1
		Automjet IVEKO nr.BZCFC4970002096545 Targa KO 6774 A		
1	F.V	Riparim motori (komplet ,kemish,fasho ,pistona,guanicion)	set	1

2	F.V	Riparim freksion (komplet disqe,speci disk,gushineta freksioni)	set	1
		MERCEDEZ BENZ WDB2020181A441864 viti 1996 KO 8326 B		
1	F.V	Nderim pompe benzine +injektor	set	1
2	F.V	Riparim i sistemit te ndezjes kandlele +fije kandlele	set	1
3	F.V	Nderim amortizator para+mbrapa	cope	4
		Benz 11-17 WDB67605215265632 Viti 1986 KO 2546 B		
1	F.V	Riparim i platformes ngritese	cope	1
2	F.V	Riparim i pistonit hidraulik te ngritjes	cope	1
3	F.V	Riparim pompe naftë + injektor	set	1
		FORD TRANZIT WF0AXXGBVASY71563 Viti 1995 KO 0061 A		
1	F.V	Riparim motori (guanicion,testate,fasho ,pistona)	set	1
2	F.V	Riparim sistemi i transmisionit (kryqe,gushineta kryqi,gushinet nivelimi)	set	1
		NISAN NAVARA,VITI2007,VSKCVND40U0203841 ,AA822VJ		
1	F.V	Nderim partikulari	set	1
2	F.V	Riparim i sistemit I drejtimi zbare,koke paraleli,amortizator para	set	1
3	F.V	Nderim transmisioni ,kryqe ,kuzhinjete	set	1
4	F.V	Nderim pasqyra ferrota para	set	1
		JCB 3CX AF MT 08 nr. 1339361 vit 2008		
1	F.V	Riparim motorino + dinamo (pinion,automat,karbočina,kolektor)	cope	1
2	F.V	Riparim pompe naftë	set	1
3	F.V	Nderim elektrovalvula kamio	set	1
		JCB 2CX nr . SLP2CXAS2E0925590 KO 77 18 B		
1	F.V	Riparim piston hidraulik perpara	cope	2
2	F.V	Riparim piston hidraulik mbrapa	cope	2
		JCB 3CX nr SERIAL 574263.V		
1	F.V	Riparim motori (komplet ,kemish,fasho ,pistona ,testate,guanicion)	set	1
		FADROMA JCB 3XC AK MT 77		
1	F.V	Riparim I pistonave hidraulike	set	2
2	F.V	Riparim motori (komplet ,kemish,fasho ,pistona ,testate,guanicion)	set	1
		M.BENZ 14-17 Vinc ,Shasi WDB61621415327211 Viti 1987 KO 0135B		
1	F.V	Nderim sistemin drejtues (zbare,kokzbare,paralel,kok muzo,guzhinjet)	set	1
2	F.V	Nderim ferrota para+ mbrapa	cope	4
3	F.V	Nderim depozite vaji hidraulikut kazani	set	1
4	F.V	Riparim kazani ,sponde dysHEME	set	1
		IVEKO , C50A,VITI 2005,ZCFC50A1005575452 ,Targe AB289IK		
1	F.V	Riparim pompe naftë + injektor	set	1
2	F.V	Nderim ferrota para+ mbrapa	cope	4
		Fadroma HiTACH ,APV nr.shasise W130A605490 Viti 1986 KO8205A		
1	F.V	Riparim sistemi hidraulik I koves para	set	1

2	F.V	Riparim pompe nafte+injektor	set	1
		Terheqes Volvo , shasi YV2A4B3A7SA224874 ,Viti 1994 ,KO 2098 B		
1	F.V	Nderim sistemin drejtues (zbare,kokzbare,paralel,kok muzo,guzhinjet)	set	1
2	F.V	Nderim ferrota para	cope	2
3	F.V	Nderim fosjete freni	cope	1
4	F.V	Riparim pompe nafte + injektor	set	1
		Kamion ,IFA ,W50L , shasi 503387 ,Viti 1982, targe KO 0180A		
1	F.V	Nderim sistemin drejtues (zbare,kokzbare,paralel,kok muzo,guzhinjet)	set	1
2	F.V	Nderim cepash mbrapa	set	2
3	F.V	Nderim injektoresh	set	1
4	F.V	Riparim kazani ,sponde dysHEME	set	1
		M.Benz, 207D , shasi 60131110699662, Viti 1985,KO 6056B		
1	F.V	Riparim karocerie,sponde,dysHEME	set	1
2	F.V	Nderim depozite uji	cope	1
3	F.V	Nderim radiator uji	cope	1
		M.Benz 814,shasi 814 67404215126801, Viti 1984 KO 2120B		
1	F.V	Ndrimi I pulexhove+rip	set	1
2	F.V	Ndrim balestre	cope	1
3	F.V	Nderim amortizator te gabines	cope	1
4	F.V	Nderim amortizator te aksit para	cope	2
5	F.V	Nderim fosjeta frenash mbrapa	cope	1
6	F.V	Nderim sistemin drejtues (zbare,kokzbare,paralel,kok muzo,guzhinjet)	set	1
		Kamion,M.Benz 814,shasi WDB67404215729392 ,Viti 1991,KO 6921B		
1	F.V	Nderim radiator uji	set	1
2	F.V	Nderim depozite uji	cope	1
3	F.V	Riparim injektoresh+ pompe nafte	set	2
4	F.V	Nderim balestra	cope	3

Specifikimet teknike jane hartuar pas verifikimeve te kryera ne lidhje me nevojat per sherbim te riparimit dhe mirembajtjes se mjeteve te transportit qe ka ndermarrja duke u bazuar edhe ne pervoja e viteve te meparshme.

Specifikimet teknike jane hartuar ne perputhje me nenin 36, te LPP, si dhe të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

TERMAT E REFERENCES

Objekti dhe qëllimi :

Kjo kontrate ka per qellim realizimin e sherbimeve per riparim te mjeteve te ndermarjes se sherbimeve.

Kontraktuesi duhet te kryej riparimin e mjeteve ne perputhje me standartet e kerkuara dhe specifikimet teknike me shpenzimet e tij deri ne dorezimin ne vendin e percaktuar nga Ndermarrja e Sherbimeve Publike, Bashkia Korçe.

Afati

12 muaj nga data e lidhjes se mareveshjes kuader.

Specifikimet teknike jane hartuar ne perputhje me nenin 36, te LPP, si dhe të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Sherbimet jane kerkuar sipas sasive dhe nevojane efektive per te permbushur nevojat e ndermarrjes ne menyre te plote per realizimin e sherbimeve ne interes te komunitetit.

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,**duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Kujdes:Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

NJËSIA E PROKURIMIT